

RELACION TEKNIK

OBJEKTI:

“PASTRIMI I KOLEKTORËVE KRYESORË TË UJËRAVE TË NDOTURA”

1. QËLLIMI I PUNIMEVE

Qëllimi i këtij projekti është rikthimi i kapacitetit përcjellës të kolektorëve kryesorë dhe sekondarë të ujërave të ndotura në territorin e Bashkisë Durrës, Bashkisë Kavajë, Bashkisë Krujë dhe Bashkisë Rrogozhinë, nëpërmjet pastrimit të mbetjeve të ngurta të depozituara në tubacione dhe puseta kontrolli.

Ndërhyrja synon:

- parandalimin e përmytjeve gjatë reshjeve intensive,
- përmirësimin e funksionimit të rrjetit të kanalizimeve,
- uljen e ndotjes mjedisore,
- rritjen e sigurisë higjieno-sanitare dhe cilësisë së jetesës për banorët.

2. GJENDJA EKZISTUESE DHE NEVOJA PËR NDËRHYRJE

Rrjeti i kanalizimeve në zonat e sipërpërmendura është ndërtuar kryesisht para viteve '90 dhe është projektuar për ngarkesa shumë më të ulëta se ato aktuale. Rritja e popullsisë, zhvillimi urban dhe turistik, si dhe mungesa e pastrimit periodik me mjete teknologjike, kanë sjellë:

- mbushje të seksioneve të tubacioneve deri në 30–60%,
- bllokime të shpeshta në kolektorët kryesorë,
- dalje të ujërave të ndotura në sipërfaqe,
- vështirësi në funksionimin e stacioneve të pompimit.

Problematikat janë evidentuar veçanërisht në rrugët dhe segmentet kryesore të qytetit të Durrësit (Egnatia, Abaz Çelkupa, Aleksandër Goga, Hysen Kërtusha, Kasëm Durrësi, etj.), si dhe në zonën e Golemit në Bashkinë Kavajë gjatë sezonit turistik.

3. OBJEKTI I PUNIMEVE

Objekti i punimeve përfshin:

- pastrimin e kolektorëve kryesorë dhe sekondarë të ujërave të ndotura,
- pastrimin e pusëve të kontrollit dhe pusëve të stacioneve të pompimit,
- largimin dhe transportimin e materialeve të depozituara (aluvione, rrëbime, plastikë, tekstile, mbetje të tjera),
- depozitimin e mbetjeve në vende të miratuara nga autoritetet përkatëse.

Punimet do të realizohen me automjete teknologjike autobot me presion të lartë dhe kamionë vakum, pa ndërprerje të funksionimit të rrjetit.

4. ZONAT E NDËRRHYRJES

Punimet do të zhvillohen në këto zona kryesore:

Bashkia Durrës

Punimet do të zhvillohen në kolektorët kryesorë dhe sekondarë të ujërave të ndotura në territorin e Bashkisë Durrës, me diametra tubacionesh nga Ø315 mm deri në Ø1200 mm, në segmente rrugore me problematika të përsëritura bllokimi dhe mbushjeje të seksionit, konkretisht në:

- Rruga **Egnatia**
- Rruga **Abaz Çelkupa**
- Rruga **Aleksandër Goga**
- Rruga **Andon Naçi**
- Rruga **Asti Nushi**
- Rruga **Dalip Peza**
- Rruga **Hysen Kërtusha**
- Rruga **Kasëm Durrësi**
- Rruga **Kristaq Boshnjaku**
- Rruga **Vath Turaj**
- Rruga **Bisht Kamëz**
- Rruga **Shoqëria Bashkimi**
- Rruga **Mujo Ulqinaku**
- Rruga **Shenjtorët**
- Rruga **Blerimi**
- Rruga **Glaukia**

Gjithashtu, në objekt përfshihet pastrimi i pusëve të kontrollit dhe pusëve të stacioneve të pompimit të ujërave të ndotura

Rruga “Asti Nushi”

Nje pike tjeter qe has shpesh here problematika te vazhdueshme eshte dhe rruga Asti Nushi ne zonen e Shkozetit. Kjo rruge ndodhet ne nje pjese te qytetit relativisht me intensitet te larte sherbimesh dhe fasonerish. Linja ka dimension te tubi Ø400 me gjatesi L=610m.



Rruga “Abaz Celkupa”

Kjo zonë që përfshin zonën nr.12 të faturimit, ndodhet në pjesën veri-lindje të qytetit dhe njihet jo vetëm si zonë banimi dhe zonë ku ushtrojnë aktivitetin e tyre institucione administrative dhe dhe arsimore, por edhe si zona më industriale, ku përfshihen jo vetëm Tregu i Frutave, Tregu Industrial, por edhe objekte të shumta biznesi, duke përfshirë një hapësirë relativisht të madhe, ku jetojnë dhe zhvillojnë aktivitetin e tyre një pjesë relativisht e madhe e popullsisë së qytetit.



Kolektori kryesor S-8 në rrugën “Abaz Çelkupa” është ndërtuar rreth vitit 1967, dhe është projektuar si kanal i tipit me seksion rrethor me gajtësi $L=690$ ml, dhe i përbërë nga tubacione me diametër $\varnothing 600 \div \varnothing 1000$ mm b/arme, duke filluar tek qendra elektroshtëpiake “Globe” dhe shtrihet përgjatë kësaj rruge duke shkarkuar tek kolektori i rrugës “Hysen Kërtusha”.

Kolektori kryesor i kësaj rruge është kolektor që grumbullon ujërat e ndotura të të gjithë objekteve të banimit, shkollave, qendrave tregtare, bizneseve, objekte të cilat pas viteve 90-të janë shtuar për shkak të ndryshimeve demografike që ka pësuar qyteti, duke bërë që ky kolektor të shfrytëzohet mbi kapacitetin për të cilin është projektuar.

Në këtë kolektor shkarkojnë ujërat e ndotura edhe kolektorët sekondarë të projektuar me tubacione me diametër $\varnothing 200 \div \varnothing 500$ mm betoni që shtrihen përgjatë rrugëve sekondare, si anekse të rrugës “Abaz Çelkupa”, të cilët mbledhin shkarkimet e ujërave të ndotura të blloqeve të godinave të banimit, të objekteve institucionale dhe të bizneseve. Funksionimi i kolektorëve sekondarë varet nga pastrimi, mirëmbajtja dhe mirëfunksionimi i kolektorëve kryesorë.

Periudha e gjatë e mos pastrimit me automjet teknologjik me pompë presioni të lartë, si dhe mungesa e herë pas herëshme e kapakëve të pushtave të kontrollit për shkak të fenomenit të vjedhjes, ka shkaktuar depozitime të mbetjeve të ndryshme, gjë e cila reflektohet dhe në vështirësinë me të cilën ky kolektor funksionon, dhe duke punuar me rreth 50 % të kapacitetit tij përcjellës.

Rruga “Egnatia”

Ndodhet në zonën qendrore–veriore të Durrësit. Lidh zona banimi, biznese dhe shërbime me akset kryesore të qytetit. Ka **qarkullim të lartë** këmbësorësh dhe automjetesh.

Si pjesë e rrjetit të vjetër urban të Durrësit ka **mbingarkesë gjatë reshjeve të forta** si dhe shpesh here Rrezik për **bllokime pushtash** dhe përmytje lokale



Rruga “Aleksander Goga”

Kolektori kryesor që shtrihet përgjatë rrugës “A.Goga” përfshin disa zonat nr.6, nr.7, nr.11, nr.12, nr.14, nr.17, nr.27, nr.29 të faturimit të cilat ndodhen në pjesën veriore të qytetit. Kjo zonë njihet si zona më e madhe industriale e qytetit, ku përveç godinave të banimit ka një numër të madh godinash institucionale, arsimore dhe shëndetësore, si dhe objekte të shumta biznesi, dhe që përfshin një hapësirë relativisht të madhe, ku jetojnë dhe zhvillojnë aktivitetin e tyre një pjesë relativisht e madhe e popullsisë së qytetit.

Kolektori kryesor S-12 si njëri prej kolektorëve në rrugën “Aleksandër Goga” është ndërtuar rreth vitit 1955, dhe është projektuar si kanal i tipit me seksion rrethor me gjatësi $L=1230$ ml, dhe diametër $\varnothing 600$ mm betoni, duke filluar nga supermarketi “KMY” dhe shtrihet përgjatë kësaj rruge deri pranë Spitalit Rajonal Durrës, duke shkarkuar tek kolektori i rrugës “Ahmet Ramzoti”. Kolektori $\varnothing 800$ mm b/arme me gjatësi $L=350$ ml fillon pranë Spitalit Rajonal Durrës duke ndryshuar diametër në $\varnothing 600$ mm betoni.

Në gjatësi të këtij kolektor, shkarkojnë kolektorë sekondarë me diametër $\varnothing 200 \div \varnothing 400$ mm betoni, që shtrihen në ato rruhë si anekse të rrugës “Aleksandër Goga”, ku mbledhin shkarkimet e ujërave të godinave të banimit, të objekteve institucionale dhe të bizneseve. Funkzionimi i kolektorëve sekondarë varet nga pastrimi, mirëmbajtja dhe mirëfunksionimi i kolektorëve kryesorë. Periudha e gjatë e mos pastrimit me automjet teknologjik me pompë presioni të lartë, si dhe mungesa e herë pas herëshme e kapakëve të pusetave të kontrollit për shkak të fenomenit të vjedhjes, ka shkaktuar depozitime të mbetjeve të ndryshme, gjë e cila reflektohet dhe në vështirësinë me të cilën ky kolektor funksionon, dhe duke punuar me reth 50 % të kapacitetit tij përcjellës.



Rruga “Kasem Durrresi”

Rrugë urbane brenda qytetit të Durrësit Zonë kryesisht **banimi**, me prani edhe të bizneseve të vogla. Qarkullim i moderuar, por me rëndësi për lidhjen e lagjeve përreth. Rrjet **ujësjellës–kanalizime ekzistues**, pjesë e sistemit urban të vjetër

Në përgjithësi funksionon si **sistem i përzier**:

- ujëra të zeza
- ujëra të shiut

Problematikat tipike të zonës:

- mbingarkesë e pusetave gjatë reshjeve
- bllokime periodike për shkak të kapacitetit të kufizuar
- rrezik për dalje të ujërave në sipërfaqe në raste shiu të fortë



Rruget “Ere pranverore”, “Sulejman Pitarka”, “Juba”, “Bisht Kamza”, “Tasim Kellici”, “Jezerca”

Keto rruge I perkasin zones se Kenetes. Ne kete zone hasen problem te ndryshme . Vlen per tu theksuar se si pasoj e pozicionit qe ndodhen banesat ne zonen e Kenetes problematikat jane te shumta ne kete zone.



Bashkia Kavajë

Pastrimi i kolektorëve kryesorë në rrugët:

- Taulantia
- Skuraj
- Princat Topia
- Indrit Cara
- E Gozhdes
- E Shenjt
- Emigranti
- Panairi
- Arkaxhive
- Josif Budo

Si dhe pastrimi i pusetave të kontrollit dhe puseve të stacioneve të pompimit Golem 1–5.

- Rruga Taulantia

Rruga Taulantia: L=3200 meter dhe diameter te tubit Ø400. Seksioni I mbushur 40%.



- Rruga Skuraj
Rruga Skuraj: L=1350 meter dhe diameter te tubit Ø400. Seksioni I mbushur 50%.



- Rruga Princat Topia
Rruga Princat Topia: L=2300 meter dhe diameter tubi Ø400. Seksioni I mbushur 40%



- Shetitorja Indrit Cara
Shetitorja Indrit Cara: L=1240 meter dhe dimension I tubit Ø400. Seksioni I mbushur 40%.



- Rruga E Gozhdes
Rruga e Gozhdes: L=310 meter dhe diameter I tubit Ø400. Seksioni I mbushur 30%.



- Rruga e Shenjt
Rruga e Shenjt: L= 700 meter dhe diameter te tubit Ø315. Seksioni mbushur 60%.



- Rruga Emigranti
Rruga Emigranti: L=255 meter dhe diameter te tubit Ø315. Seksioni I mbushur 40%.



- Rruga Panairi
Rruga Panairi: L=240 meter dhe diameter te tubit Ø315. Seksioni I mbushur 40%.



- Rruga e Arkaxhive
Rruga e Arkaxhive: L=240 dhe diameter te tubit Ø315. Seksioni I mbushur 30%.



- Rruga Josif Budo
Rruga Josif Budo: L=1600 meter dhe diameter te tubit Ø400. Seksioni I mbushur 20%.



Bashkia Krujë dhe Bashkia Rrogozhinë

Bashkia Rrogozhine

Pastrimi i kolektorëve kryesorë në rrugët:

- E Peqinit
- E Kavajes
- Stacioni Trenit – Qender

Bashkia Kruje

Pastrimi i kolektorëve kryesorë në rrugët:

- E Malit
- Donika Kastrioti
- Vran Konti

Ndërhyrje të lokalizuara në segmente me problematika të evidentuara, sipas të dhënave teknike të rrjetit dhe volumit të inerteve të depozituara.

5. PASTRIMI I PUSSETAVE TË UJËRAVE TË ZEZA DHE STACIONEVE TË POMPIMIT

Pastrimi i pussetave të ujërave të zeza dhe stacioneve të pompimit përbën një element thelbësor për funksionimin e qëndrueshëm të sistemit të kanalizimeve. Me kalimin e kohës, këto struktura grumbullojnë sasi të konsiderueshme sedimentesh, mbetjesh të ngurta dhe materiale flotante, të cilat pengojnë rrjedhjen normale dhe dëmtojnë pajisjet mekanike.

Punimet do të përfshijnë:

- pastrimin e pussetave të kontrollit nga sedimente dhe mbetje të ngurta,
- pastrimin e pusëve thithëse dhe baseneve të stacioneve të pompimit,
- largimin e materialeve që pengojnë funksionimin e pompave,
- shpëlarjen e strukturave me ujë nën presion të lartë,
- transportimin dhe depozitimin e mbetjeve në venddepozitime të miratuara.

Këto ndërhyrje synojnë rritjen e jetëgjatësisë së pajisjeve, uljen e defekteve teknike dhe sigurimin e funksionimit të pandërprerë të stacioneve të pompimit, veçanërisht gjatë periudhave me ngarkesë të lartë hidraulike.

Pastrimi i puseve do të realizohet në këto zona:

a) Bashkia Durrës

Në qytetin e Durrësit kemi 13 stacione pompimi dhe 4 stacione në zonën e Gjirit të Lalezit

Ujërat e ndotura të pjesës jugore të qytetit të Durrësit mbledhen me rrjedhje të lirë në Stacionin e Pompave nr.8, ku prej andej dërgohen në Stacionin kryesor të Pompimit nr.7 ndërtuar në vitin 2018 me investimet e Bankës Botërore, dhe po në këtë stacion dërgohen të gjithë ujërat e pjesës veriore dhe perendimore të qytetit. UN të qytetit të mbledhura në Stacionin nr.7 dërgohen në Stacionin e Pompave nr.9 dhe prej andej me tubacion HDPE Ø 800 mm dërgohen në Impiantin e Trajtimit e Përpunimit, në të cilin pasi trajtohen derdhen në Kanalin e

Hapur i cili me rrjedhje të lirë për rreth 8 km i dërgon ato në Hidrovorin e Porto-Romanos, për t'u derdhur më tej në det.

1. Stacioni i pompimit nr 1/1
2. Stacioni i pompimit nr 1/2
3. Stacioni i pompimit nr 1/3
4. Stacioni i pompimit nr 1
5. Stacioni i pompimit nr 2
6. Stacioni i pompimit nr 3
7. Stacioni i pompimit nr 4
8. Stacioni i pompimit nr 5
9. Stacioni i pompimit nr 5/1
10. Stacioni i pompimit nr 6
11. Stacioni i pompimit nr 7
12. Stacioni i pompimit nr 8
13. Stacioni i pompimit nr 9
14. Stacioni i pompimit Gjiri Lalezit nr.1
15. Stacioni i pompimit Gjiri Lalezit nr.2
16. Stacioni i pompimit Gjiri Lalezit nr.3
17. Stacioni i pompimit Gjiri Lalezit nr.14

b) Bashkia Kavajë – Zona Golem

Puset e stacioneve të pompimit janë 5

- Golem 1
- Golem 2
- Golem 3
- Golem 4
- Golem 5

Për shkak të relievit tërësisht të sheshtë dhe kuotave të ulëta të terrenit, sistemi i kanalizimeve në Golem nuk mund të funksionojë vetëm me rrjedhje gravitacionale. Si pasojë, ujërat e ndotura të grumbulluara nëpërmjet pusetave të kontrollit dhe kolektorëve sekondarë derdhen fillimisht në pusetat thithëse të këtyre pesë stacioneve të pompimit. Në basenet e tyre janë të instaluar pompa zhytëse, të cilat aktivizohen automatikisht në varësi të nivelit të ujit dhe sigurojnë ngritjen hidraulike të ujërave të zeza.

Nga stacionet **Golem 1–5**, ujërat e ndotura pompohen përmes tubacioneve të presionit dhe shkarkohen në **kolektorin kryesor rajonal**, i cili i përcjell ato nga prroi I Agasit drejt **Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Ndotura (ITUN)** të zonës së Kavajës për trajtim të mëtejshëm, në përputhje me standardet mjedisore në fuqi.

Stacionet e pompimit të Golemit përballen me ngarkesa të larta sezonale, sidomos gjatë periudhës verore, kur fluksi turistik rrit ndjeshëm sasinë e ujërave të ndotura. Grumbullimi i sedimenteve, rërës dhe mbetjeve të ngurta në pusetat hyrëse dhe basenet e pompimit ul ndjeshëm eficiencën e pompave, rrit riskun e bllokimeve dhe shkakton ndërprerje në funksionimin normal të sistemit.

Pastrimi periodik i pusetave, baseneve të thithjes dhe elementëve hidraulikë të stacioneve **Golem 1–5** është i domosdoshëm për garantimin e funksionimit të vazhdueshëm të rrjetit të kanalizimeve, shmangien e daljeve të ujërave të ndotura në sipërfaqe dhe mbrojtjen e mjedisit bregdetar të zonës së Golemit.

6. VOLUMET E PUNIMEVE DHE NJËSIA E MATJES

Volumet e punimeve për pastrimin e kolektorëve, pusetave dhe stacioneve të pompimit janë përcaktuar në bazë të gjatësisë së segmenteve, diametrit të tubacioneve, nivelit të mbushjes së seksioneve dhe sasisë reale të materialeve të larguara (sedimente, rërë, mbetje urbane etj.).

Njësia e matjes e punimeve është **metër kub (m³)**, duke reflektuar volumet reale të inerteve dhe mbetjeve të grumbulluara dhe transportuara për depozitim në vendet e miratuara nga autoritetet përkatëse.

Ky sistem matjeje siguron një përlllogaritje të saktë të punimeve dhe lehtëson përcaktimin e fondit limit për zbatimin e ndërhyrjeve, duke garantuar transparencë, kontroll dhe përputhje me standardet teknike dhe mjedisore.

7. PERFUNDIME

Pastrimi i kolektorëve kryesorë dhe sekondarë, i pusetave të kontrollit dhe i stacioneve të pompimit në territorin e Bashkisë Durrës, Kavajë, Krujë dhe Rrogozhinë, përbën një ndërhyrje të domosdoshme për garantimin e funksionimit normal të rrjetit të kanalizimeve dhe për parandalimin e përmytjeve urbane.

Realizimi i punimeve do të sigurojë:

- rikthim të kapacitetit përcjellës të kolektorëve,
- funksionim të pandërprerë të pusetave dhe stacioneve të pompimit, veçanërisht në zonat me ngarkesë sezonale si Golemi,
- ulje të ndotjes mjedisore dhe përmirësim të kushteve higjieno-sanitare për komunitetin.


Përcaktimi i volumit të punimeve dhe i njësisë së matjes në **metër kub (m³)** siguron një bazë të saktë për planifikimin e resursteve, fondit limit dhe kontrollin e cilësisë së punimeve.

Në përfundim, ndërhyrjet e propozuara garantojnë një rrjet kanalizimesh më të qëndrueshëm, funksional dhe të sigurt për qytetarët dhe mjedisin urban.

METODOLOGJIA E PROCESIT TE PUNES


1-1 Automjetet teknologjik me pompe presioni te larte

Vendosni automjetet në anën e poshtme të kanalizimeve.




1-2 Sonada e presionit te larte.

Lidhni një hundë në një zorrë me presion të lartë.




1-3 Automjet teknologjik me pompe presioni te larte.

Pas futjes së sondes në kanalizim, vendosni një rul udhëzues.




1-4 Automjet teknologjik me pompe presioni te larte dhe autobot furnizimi me uje.

Lidhni një zorrë për furnizimin me ujë të Automjetit teknologjik me pompe presioni të lartë nga autoboti i ujit. Lidhni një zorrë tjetër në valvulën e thithjes së kamionit të depozitës së llumit, futeni në kanalizim.




1-5 Kamion me vakum



2. Operacioni punes


2-1 Automjet teknologjik me pompe presioni te larte

Rrjedha e ujit me presion të lartë e bën hundezën të shkojë përpara në kanalizim. Hunda ka impulsione duke nxjerrë ujë me presion të lartë.




2-2 Pastrues uji

Hundeza mbështillet me mbështjellje dredha-dredha hidraulike dhe akumulimi materialit do të mblidhet nga uji me presion të lartë nga hunda.




2-3 Kamion me vakum me rezervuar llumi

Pas thithjes së llumit nga kamioni vakum me rezervuar llumi, keni dy mënyra shkarkimi.




1. Kur bëni presion në rezervuarin e marrësit, ai mund të shkarkojë ujërat e zeza përsëri në kanalizim menjëherë pa e ngritur rezervuarin e llumit.
2. Ngrini rezervuarin e llumit lart dhe kthejeni ujërat e zeza në kanalizim.




2-4 Kamion me vakum

Kur rezervuari i marrësit është plot, edhe pse kryeni operacionin e mësipërm 2-3.

Kamioni me rezervuar të llumit hedh materialin e trashe te akumuluar ne vendepozitim e percaktuar.




Duke vendosur kamionë të tjerë me vakum me rezervuar llumi, do të mund të operojnë vazhdimisht pa nderprere procesin e pastrimit.



2-5 Kamion me vakum me krike

Kamioni me vakum me krike është në gjendje të shkarkojë ujërat e zeza me anë të sistemit të dehidrimit njëloj si Kamioni i depozitës së llumit dhe kamioni e ngarkon materialin në kamionë të tjerë me krike si më poshtë.



VOLUMET E PUNIMEVE.

Volumet kryesore të punimeve janë:

Nr	Emertimi I rruges	Diametri I tubit (mm)	Gjatesia (m)	Seksioni I mbushur (%)	Volumi I inerteve (m3)	Numri I pusetave (cope)	Dimensioni soletes se pusetave (m)	Volumi I inerteve (m3)
Bashkia Durres								
1	Vath Turja	400	985	50	61.86	33	0.8 x 0.8	8.45
2	Asti Nushi	400	610	40	30.65	20	0.8 x 0.8	3.84
3	Nenstacioni	400	425	50	26.69	17	0.8 x 0.8	4.35
4	Egnatia	1200	1010	40	456.68	33	1.5 x 1.5	29.70
5	Abaz Celkupa	1000	1000	40	314.00	38	1.5 x 1.5	34.20
6	Aleksander Goga	400	310	30	11.68	16	0.8 x 0.8	4.10
7	Kasem Durresi	1200	400	40	180.86	13	1.5 x 1.5	11.70
8	Hysen Kertusha	1000	940	40	295.16	37	1.5 x 1.5	33.30
9	Andon Naci	500	640	40	50.24	17	0.8 x 0.8	4.35
10	Kristaq Boshnjaku	1000	270	40	84.87	10	1.5 x 1.5	9.00
11	Adria	315	1200	40	37.39	40	0.8 x 0.8	10.24
12	Dalip Peza	600	432	50	61.04	18	1 x 1	7.20
13	Juba	400	800	50	50.24	30	0.8 x 0.8	7.68
14	Bisht Kamza	400	800	40	40.19	30	0.8 x 0.8	7.68
15	Tasim Kellici	400	800	50	50.24	30	0.8 x 0.8	7.68
16	Porto Romano	400	800	50	50.24	30	0.8 x 0.8	7.68
17	Jezerca	400	800	40	40.19	30	0.8 x 0.8	7.68
18	Sulejman Pitarka	400	800	60	60.29	30	0.8 x 0.8	7.68
19	Ere Pranverore	400	800	40	40.19	32	0.8 x 0.8	8.19
20	Tubacion I Kunetave Te Shiut	200	2500	50	39.25			
21	Pusetat E Ujerave Te Shiut					650	0.6 x 0.3	58.50
22	Stacioni I Pompimit 1/1						3.0 x 2.2	7.92
23	Stacioni I Pompimit 1.2						3.2 x 3.0	14.40
24	Stacioni I Pompimit 1.3						3.3 x 3.0	14.85
25	Stacioni I Pompimit 1						Ø 7.1 m	39.57
26	Stacioni I Pompimit 2						Ø 7.1 m	47.49
27	Stacioni I Pompimit 3						2.0 x 1.8	3.60
28	Stacioni I Pompimit 4						Ø 8 m	60.29
29	Stacioni I Pompimit 5						Ø 8 m	40.19
30	Stacioni I Pompimit 5.1						5.3 x 5.1	27.03
31	Stacioni I Pompimit 6						Ø 7.6 m	27.20
32	Stacioni I Pompimit 7						Ø 7.9 m	24.50
33	Stacioni I Pompimit 8						Ø 4.9 m	37.70
34	Stacioni I Pompimit 9						Ø 3.6 m	8.14
35	Stacioni I Pompimit Gjiri I Lalezit Nr.1						Ø 3.6 m	10.17

36	Stacioni I Pompimit Gjiri I Lalezit Nr.2						Ø 3.6 m	12.21
37	Stacioni I Pompimit Gjiri I Lalezit Nr.3						Ø 3.6 m	8.14
38	Stacioni I Pompimit Gjiri I Lalezit Nr.4						Ø 4.4 m	12.16
Bashkia Kavaje								
39	Taulanti	400	3200	40	160.77	110	0.8 x 0.8	28.16
40	Skuraj	400	1350	50	84.78	42	0.8 x 0.8	10.75
41	Princat Topia	400	2300	30	86.66	71	0.8 x 0.8	18.18
42	Shetitorja Indrit Cara	400	1240	40	62.30	38	0.8 x 0.8	9.73
43	E Gozhdes	400	310	30	11.68	12	0.8 x 0.8	3.07
44	E Shenjte	315	700	40	21.81	23	0.8 x 0.8	5.89
45	Emigranti	315	255	40	7.94	10	0.8 x 0.8	2.56
46	Panairi	315	240	40	7.48	9	0.8 x 0.8	2.30
47	E Arkaxhive	315	240	30	5.61	9	0.8 x 0.8	2.30
48	E Luleve	315	80	40	2.49	4	0.8 x 0.8	1.02
49	Josif Budo	400	1600	20	40.19	45	0.8 x 0.8	11.52
50	Stacioni I Pompimit Golem 1						Ø 4.8 m	6.03
51	Stacioni I Pompimit Golem 2						Ø 4.8 m	7.54
52	Stacioni I Pompimit Golem 3						Ø 5.4 m	11.02
53	Stacioni I Pompimit Golem 4						Ø 5.4 m	6.78
54	Stacioni I Pompimit Golem 5						Ø 6.2 m	9.73
55	Tubacion I Kunetave Te Shiut	200	1000	40	12.56			
56	Pusetat E Ujerave Te Shiut					250	0.6 x 0.3	22.50
Bashkia Rrogozhine								
57	Peqinit	600	820	30	69.52	27	1 x 1	10.8
58	Kavajes	600	750	30	63.59	25	1 x 1	10
59	Stc. Trenit - Qender	600	650	30	55.11	22	1 x 1	8.8
60	Tubacion I Kunetave Te Shiut	200	600	30	5.65			
61	Pusetat E Ujerave Te Shiut					180	0.6 x 0.3	16.2
Bashkia Kruje								
62	Malit	315	500	30	11.68	14	0.8 x 0.8	3.58
63	Donika Kastrioti	315	300	30	7.01	10	0.8 x 0.8	2.56
64	Vran Konti	315	400	30	9.35	12	0.8 x 0.8	3.07

65	Tubacion I Kunetave Te Shiut	200	500	30	4.71			
66	Pusetat E Ujerave Te Shiut					150	0.6 x 0.3	13.5
	Kolektor mbi 315	2650.58						
	Kolektor nen 300	62.17						
	Puseta	459.70						
	Stacion pompimi	436.66						

KONKLUSIONE.

Në përfundim të projektit për zonën në studim me objekt: “PASTRIM KOLEKTORËVE TË UJËRAVE TË NDOTURA” konkludojmë si më poshtë:

Projekti do të realizohet në një fazë .

Preventivat e zbatimit janë vlerësuar sipas VKM. Nr.216 date 13.04.2023 dhe studimit të tregut. Analizat e çmimeve sipas normativave të tregut.

Grupi Hartimit të Kritereve dhe Specifikimeve Teknike

Ing.Tonin Doda

Z.Bledar Kllojka